



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:168639

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06746452

P.nr.110/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit A E nga Klina rruga „D K për shkak të veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.847/2024 të datës 24.06.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt.17.12.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala dhe i pandehuri A E dhe mbrojtësi i tij sipas detyres zyrtare av.Flamur Kelmendi, me dt.20.12.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.01.2025, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A E, nga i ati A e ëma F e gjinisë B, i lindur me datë në K ku dhe tani banon rruga,, D e K,, me nr.personal, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, recidivist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 20.05.2024, rreth orës 00:45, në fshatin Z, Komuna e K, tek lokali i natës,, M përdorë armën në kundërshtim me ligjin për armët dhe atë pistoletë e llojit „SIG SAUSER,, e kalibrit „ 7,65,, me nr.serik 000867/0718, në mënyrën që, pasi që i pandehuri shkon tek lokali i lartëcekur për të qëndruar, i njëjti në një moment del nga lokali dhe në oborrin e parkingut të po të njëjtit lokal nxjerr armën e tij duke shkrepur dy (2) herë në ajër dhe pas këtij veprimi i njëjti largohet në drejtim të panjohur.

Me çka ka kryer vepër penale,,Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm,, nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II. Më parë e gjer datë 20.05.2024, rreth orës 00:45, në fshatin Z, Komuna e K, tek lokali i natës,, M mban në pronësi armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla dhe atë pistoletë e llojit „SIG SAUSER,, e kalibrit „ 7,65,, me nr.serik 000867/0718, në mënyrën që, pasi që i pandehuri fillimisht siguron armën nga burimi ende i panjohur, e më pas kryen veprën nga pika 1, i njëjti pesë (5) ditë më vonë, paraqitet vullnetarisht dhe dorëzon pistoletën e përdorur, për të cilën nuk ka leje për posedim nga organi kompetent.

me çka ka kryer vepër penale, Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7 , 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69,70 dhe nenit 366 par. 1 dhe 367 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit: A E,

Gjykata i përcakton :Sipas dispozitivit -I- denim Burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (2) vite, nuk kryen vepër të re penale.

Sipas dispozitivit -II- I përcakton denim Burgu në kohëzgjatje prej shtatë (7) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) nuk kryen vepër të re penale.

ME DËNIM UNIK Konform nenit 76 të KPRK-së.

Gjykata e dënon me Dënim Burgu në kohëzgjatje prej shtatëmbëdhjetë muaj (17) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej tri (3) vite, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 3 (tri) vite, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV. Konfiskohet, arma e llojit-pistoleta e llojit „SIG SAUER,, kalibër 7.65 mm me nr. Serik 000867/0718, karikator i pistoletës, dhe dy (2) gëzhoja kalibër 7.65 mm, të njëjtat të shkatërrohen .

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.847/2024 e datës 24.06.2024, kundër të pandehurit A E nga K rruga „Dëshmorët e Kombit,, për shkak të kryerjes së veprave penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezkishëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale; Mbajtja në pronësi, kontroll posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 i KPRK-së.

Gjykata me datë 17.12.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i pandehuri A E si dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av.Flamur Kelmendi.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.17.12.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri A E pas konsultimit

paraparak të mbrojtësit të tij av.Flamur Kelmendi, ka deklaruar se e pranon fajësinë për dy veprën penale që i vihej në barrë, më vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprat e penale të kryera, po ashtu deklaroi pasi që isha në lokal në fshatin Z te M mu më erdh një telefonat pasi që e kisha nënën shumë të sëmur, më njoftuan se nëna ishte më mirë dhe nga gëzimi une dola dhe kam gjuajtur në ajër dy herë, i premtoj Gjykatës se që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjajshme penale, po ashtu kërkoj falje publike në këtë seancë.

I njëjti i dorëzon gjykatës shkresat se nënën e ka të sëmur, duke e mjekuar nga diabeti dhe sëmundje të tjera shoqëruese , ku dhe ja kanë amputuar këmbën e cila e ka moshën 65 vjeq, kërkoj nga Gjykata që të më shqiptoj një dënim më të butë pasi që kamë shpenzime rreth mjekimit të nënës sime , i pandehuri ja ka dorëzuar Gjykatës dëshmit.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av.Flamur Kelmendi, ka deklaruar se; pas konsultimeve me të mbrojturin tim A E dhe shpjegimi për mundësin e pranimit apo mospranimit të fajësis, i njëjti pa kurrfarë kërcënimi apo ndikimi ka vendos që të pranon fajësinë, prandaj une e mbështes pranimin e fajësis dhe lus gjykatën që pas marrjes së vendimit për dënimin të ketë parasysht gjendjen e tij të dobët financiare se asnjëri nga familjarët nuk është në marrëdhënje pune se vet i pandehuri punon vetëm veres si punëtor fizik dhe me ato mjete të siguruara kujdeset sado pak për familjen e sidomos për nënën e vet e cila ka vuajtur dhe vuan nga një sëmundje të eshtrave dhe sot e njëjta gjendet në kontrollin e mjekëve. Prandaj e lus gjykatën që të pranaj fajësin pranimin e fajësis dhe mbi bazën e nenit 71 të KPRK-së, të pandehurit të i shqiptoj një dënim sa më të butë, e sidomos për faktin se i njëjti edhe tani gjendet në marrëdhënje të punës.

Deklarimi i palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij , pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i ka

propozuar gjykatës që të merr parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjesisë penale.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykyese pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja e vetme gjykyese ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale, të cilat mbështesin aktakuzën, si : Raporti i oficerit M M #4328 nr.i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Shënim zyrtar nga zyrtari policor R G #0056 nr.i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje në polici për dëshmitarin M A nr.i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje në polici për dëshmitarin P Z nr.i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin A E nr. i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Vërtetim mbi sekuestrimin e sendeve nr. i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës me nr. i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Foto-Albumi nga vendi i ngjarjes dhe nga njësia e forenzikës me nr. i dokumentit 2024-DE-207 i dt.20.05.2024, Kërkesë për sekuestrimin e armëve dhe municionit nga Stacioni Policor -Klinë me nr. i dokumentit 2024-DE207 i dt.20.05.2024, Procesverbal i marrjes së deklaratës së të pandehurit në procedurë paraprake PP/II.nr.847/2024 i dt.14.06.2024, Aktvendim për bashkimin e lëndëve PP/II.nr.847/2024 i dt.13.06.2024, Urdhër për ekzaminim PP/II.nr.847/2024 i dt.20.05.2024, Çertifikatë e regjistrimit lëshuar nga ARBK me nr.unik identifikues 812136936.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Bazuar në të lartëcekurat gjyqtari i vetëm gjykyes ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen,, Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesë qind (7.500) euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet , dhe vepra penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK, ku parashihet dënimi me burgim prej 1 (një) viti deri në 8 (tetë) vite.

Andaj bazuar në të lartëcekura, Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale,, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedimi i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale „Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, nga se veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së duke e vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, padënueshmërinë e tij më parë, ndërsa si rrethana posaqerisht lehtësuese konform nenit 71 muar, sjelljen e tij më parë si dhe sjelljen e mirë pas kryerjes së veprës penale, poashtu si rrethanë lehtësuese muar se i pandehuri është mbajtës i vetëm i familjes dhe i pa punë, dhe nënën e ka të sëmurë e cila vuan nga shumë sëmundje, e të cilës i është amputuar këmba ndërsa rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata nuk ka gjetur.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsistot në parandalimin e të njëjtit nga kryerje e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par.2.6 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartëcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.110/2024 me datë 23.01.2025

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

Bashkëpunëtorja profesionale

Fatmire Elezaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.